

**UDHEREFYESI
PER ARTERIOPATINE OBLITERANTE TE
GJYMTYREVE TE POSHTME**

Publikimi: Dhjetor 2010

Rishikimi: Sipas nevojës

Grupi i punës për Angiologji :

Sokol XHEPA, Kryetar
Gentian CACO, sekretar
Edmond KAPEDANI, anëtar

Vladimir GUSMARI, anëtar, përfaqësues i QKCSA
Arian BREGU, anëtar , MSH
Naun SINANI , anëtar , ISKSH

Pasqyra e lendet

Lista e shkurtimeve gjuhesore	6
Perkufizimi i termave te perpilimit	7
Parathenia	8
Objektivi	9
Perberja	10
Popullata e interesuar	10
Pershkrimi klinik	10
Rekomandimet diagnostikuese	11
Rekomandimet trajtuese	12
Bibliografia	16

Pasqyra e tabelave

faqe

Tabela 1.

Vleresimi klinik i gravitetit te AOP sipas klasifikimit te Fontaine. 10

Tabela 2.

Vleresimi orientues i gravitetit te AOP ne baze te ABI 11

Pasqyra e figurave

Liste e shkurtimeve gjuhesore (Akronimeve)

AOP Arteriopatia obliterante periferike (e gjymtyreve inferiore)

ABI Indeksi kavilje – krah (ankle – brachial index) eshte rapporti i presionit sistolik te matur me Doppler ne arteriet tibiale anteriore dhe posteriore ne nivel te kaviljes me presionin sistolik te matur me metoden e zakondshme ne krah.

PERKUFIZIMI I TERMAVE TE PERPILIMIT

AOP	Arteriopatia obliterante periferike, ose AO e gjymtyreve inferiore, ose Semundja e arterieve te okluduara te gjumtyreve inferiore. Karakterizohet nga stenozat e okluzionet e arterieve te gjymtyreve te poshtme, ne nivele te ndryshme, zakonisht me prekje bilaterale. Eshte semundje kronike, progresive.
Klaudikacioni intermitent	Dhimbje qe shfaqet ne muskujt e gjymtyreve te poshtme gjate ecjes. Eshte simptomi karakteristik per ishemine e gjymtyreve inferiore ne stadet e kompensuara. Korespondon me stadin e dyte te klasifikimit sipas Fontaine te AOP.
Ishemia kritike	Cilesohet e tille gjendja e ishemise se thelle te gjymtyreve inferiore qe shprehet me dhimbje te vazhdueshme te lokalizuara ne gishtat ose shputen e kembes edhe ne gjendje qetesie dhe gjate nates, ftohje, mpirje te kembes e ndonjehere edhe me enjtje, skuqje dhe pranine e plageve nekrotike ne kembe. Korespondon me stadin e trete te klasifikimit Fontaine ose me akutizimin e semundjes.

PARATHENIE

AOP eshte nje semundje relativisht e shpeshe ne moshat e medha, me shkalle te larte invaliditeti dhe morbiditet te larte.

Studimet e medha te kryera ne vende te ndryshme deshmojne per prevalence 3-10% ne populete ne per gjithese dhe 15-20% nese merret ne konsiderate popullata mbi 70 vjec. Prevalanca rritet ne menyre proporcionale me moshen.

Semundja prek njerez me ateroskleroze te avancuar, rrjedhimisht me risk te larte per komplikacione kardio-vaskulare.

Shpesh simptomat e semundjes ngaterohen me patologji osteo-artikulare e neurologjike. Per kete arsyet pacientet shpesh paraqiten tek mjeku specialist ne stade te avancuara te semundjes kur edhe mundesite e trajtimit jane te vogla.

OBJEKTIVI

Depistimi, diagnoza e hereshme dhe trajtimi optimal sipas stadeve te evolucionit klinik te semundjes.

PERDORUESIT mjeket e familjes

PERBERJA:

Popullata e interesuar

AOP prek kryesisht individet e moshes se trete qe kane faktore risku per aterosklerozen (pirja e duhanit, hipertensioni, dislipidemia, diabeti i shendetit, etj.). Semundja eshte me e shpeshte tek meshkujt (raporti meshkuj/femra = 2/1 – 4/1), ne pacientet me diabet melitus (20% e pacienteve me AOP jane diabetike) dhe ne pacientet me insuficience renale kronike. Prevalanca e semundjes se arterieve koronare, semundjeve cerebro-vaskulare, semundjes obstruktive pulmonare ne keta paciente eshte shume me e larte sesa ne popullaten e te njejtes moshe.

Pershkrimi klinik

Semundja ka disa stade dhe forma klinike ne varesi te gravitetit dhe perhapjes se lezionateve stenotike e okluduese te arterieve.

Ne baze te nivelit te lezionateve dallohet AOP aorto-iliake (uni ose bilaterale), AOP iliake, femorale, femoro-popliteale, popliteo-krurale etj. Semundja mund te preke njekohesht disa nivele ne te dyja gjymtyret inferiore. Niveli i okluzioneve percaktohet ne baze te simptomave dhe shenjave klinike dhe vertetohet me ekzaminimet angio-radiologjike.

Ne baze te gravitetit te ishemise dallohen kater stade klinike (sipas klasifikimit te Fontaine):

Tabela 1. Vlereaimi klinik i gravitetit te AOP sipas klasifikimit te Fontaine.

Stadi I	Paciente asimptomatike ku semundja zbulohet gjate nje ekzaminimi.
Stadi II	Ishemi e kompensuar qe shfaqet me klaudikacion intermitent te muskujve te pulpes, kofshes, ose rregjonit gluteal.
Stadi III	Ishemi ne qetes (forma e dekompensuar). Karakterizohet nga shfaqja e dhimbjeve edhe ne qetes, jo vetem gjate ecjes.
Stadi IV	Nekroza e gangrena. Karakterizohet nga shfaqja e plageve nekrotike zakonisht ne gishtat ose themren e kembes se interesuar ose me gangrenen e kembes

Rekomandimet diagnostikuese

A. Ekzaminimi i pulseve ne arteriet periferike te gjymtyreve te poshtme duhet te jete pjesa integrale e vizites klinike te pacienteve nga mjeku i per gjithshem. Kjo eshte me shume vlore per diagnozen e hereshme te AOP, sidomos tek te moshuarit (mbi 60 vjec), tek patientet me faktore rishku ose shprehje te tjera te aterosklerozes dhe tek diabetiket. (*Grada e rekomandimit B*)

B. Matja e ABI eshte e nevojshme:

- Tek te gjithe patientet qe paraqesin simptoma sugjeruese per AOP.
(*Grada e rekomandimit B*)
- Tek patientet 50-70 vjec qe kane faktore rishku per aterosklerozen.
(*Grada e rekomandimit B*)
- Tek te gjithe patientet mbi 70 vjec, edhe kur nuk kane faktore rishku per aterosklerozen.
(*Grada e rekomandimit B*)
- Te gjithe patientet diabetike qe paraqesin nje plage, ulcer ose nekroze te gishtave, themres ose shputes se kembes.
(*Grada e rekomandimit C*)

Tabela 2. Vleresimi orientues i gravitetit te AOP ne baze te ABI

ABI > 0,9	Pacienti nuk ka AOP te rendesishme
ABI = 0,7 – 0,9	Pacienti paraqet ishemi te kompensuar mire me kaudikacion jo invalidizues.
ABI = 0,5 – 0,7	Pacienti paraqet kaudikacion invalidizues
ABI < 0,5	Pacienti paraqet ishemi te avancuar, madje deri ishemi kritike

C. Ekzaminimet me speciale qe perdoren ne diagnozen e AOP jane Echo-Doppler, Angiografia, Angio-CT (angio-skaner), angio-RM (angio-rezonance). Keto ekzaminime tregojne shtrirjen anatomike te lezioneve dhe kane vlore per percaktimin e metodave trajtuese invazive (kirurgjikale ose endovaskulare). Keto ekzaminime nuk jane te nevojshme per depistimin dhe diagnozen fillestare te AOP. Ato indikohen nga specialisti ne varesi te nevojave terapeutike te patientit. (*Grada e rekomandimit C*).

Rekomandimet trajtuese

A. Modifikimi i faktoreve te riskut

Modifikimi i faktoreve te riskut eshte i domosdoshem dhe madje hapi i pare i terapise ne pacientet me AOP. Kjo ndikon drejt per drejte ne permiresimin e simptomave dhe sidomos te prognozes se semundjes dhe prognozes se jetes.

- Te gjithe pacientet me AOP qe pijne duhan duhet te keshillohen fort dhe ne menyre te perseritur per ta nderprere duhanin. (*Grada e rekomandimit B*)
- Te gjithe pacientet me AOP dhe dislipidemi duhet te trajtohen me djete dhe preparate antilipemiante me qellim uljen e LDL-kolesterolit dhe/ose triglycerideve. Vlerat e rekomanduara te LDL-kolesterolit per pacientet me AOP jane: <100 mg/dl (*Grada e rekomandimit A*). Ne pacientet qe paraqesin prekje nga ateroskleroza edhe ne sisteme te tjera vaskulare (SIZ, Semundje cerebro-vaskulare, etj) LDL-kolesteroli duhet te mbahet < 70 ,g/dl (*Grada e rekomandimit B*). Statinat jane preparate e zgjedhura si terapi e pare per dislipidemine ne pacientet me AOP (*Grada e rekomandimit A*).
- Te gjithe pacientet me AOP dhe HTA duhet te trajtohen me synim mbajtjen e TA ne vlerat < 140/90 mmHg dhe nese jane diabetike ose me IRK < 130/80 (*Grada e rekomandimit A*). Tiazidiket dhe ACE-inhibitoret duhet te konsiderohen si barnat e linjes se pare ne keta paciente (*Grada e rekomandimit B*). Beta-bllokuesit nuk jane te kundraindikuar tek pacientet me AOP (*Grada e rekomandimit A*).
- Tek te gjithe pacientet diabetike me AOP duhet te sigurohet kontroll agresiv i glicemise me synim mbajtjen e nivelit te HbA1 < 7% (*Grada e rekomandimit C*).

B. Trajtimi me antiagregante

- Te gjthe pacienteve me AOP duhet tu përshtruhet terapi afatgjate me një antiagregant me qellim uljen e riskut për morbiditet e mortalitet kardiovaskular (*Grada e rekomandimit A*). Aspirina në doza të vogla është efektive në pacientet me AOP që kane edhe semundje të tjera kardio-vaskulare (*Grada e rekomandimit A*).
- Clopidogreli dhe Ticlopidina mund të perdoren në vend të Aspirinës me të njejtin qellim (*Grada e rekomandimit B*). Terapia me dy antiagregante njehersh nuk rekomandohet në rutine në pacientet me AOP.
- Trajtimi me antiagregante duhet të vazhdoje edhe pas trajtimeve kirurgjikale apo endovaskulare. Përvec rasteve me kundraindikacion specifik ky mjekim duhet vazhduar pa kufizim në kohe. (*Grada e rekomandimit A*)

C. Trajtimi simptomatik konservativ i klaudikacionit

- Pacientet me AOP në stadin e klaudikacionit intermitent duhet të rekomandohen të bejne ecje cdo dite pasi është vertetuar permiresimi i perimetrit të ecjes. (*Grada e rekomandimit A*)
- Pacientet me klaudikacion intermitent mund të trajtohen me Naftidrofuryl. (*Grada e rekomandimit A*)

D. Trajtimet kirurgjikale dhe endovaskulare

Synojne rivaskularizimin e gjymtyres duke trajtuar lezionin anatomic okluziv (endarterekomi, plastika të ndryshme kirurgjikale, angioplastika perkutane dhe vendosje e stenteve endovaskulare) ose duke e anashkaluar atë me bypass-e të ndryshme.

Teknikat kirurgjikale dhe endovaskulare kane indikacione të ndryshme në varesi të lokalizimit të lezioneve, shtrirjes dhe kompleksitetit të tyre, teknologjise se disponueshme dhe pervojes se specialisteve perkates nga njera ana dhe graviteti i ishemise dhe gjendja funksionale e pacientit nga ana tjeter.

- Trajtimi kirurgjikal ose endovaskular ka indikacion te zgjedhur ne pacientet me ishemi kritike (Stadi III dhe IV sipas Fontaine). Perpara marrjes se vendimit duhet vleresuar funksioni i organeve e sistemeve vitale te organizmit per te parashikuar morbiditetin e mortalitetin e interventit.
- Ne stadin e kaudikacionit intermitent (ishemi e stadir II sipas Fontaine) indikacioni per trajtim kirurgjikal ose endovaskular eshte relativ. Ai varet nga disa faktore.
 - Mosha e re, invalidizimi dhe kufizimi i aktivitetit jetesor te pacientit, gjendja funksionale e mire e pacientit (pacient pa semundje shoqueruese te renda), lezionet e thjeshta per tu trajtuar, pacient qe eshte ne gjendje te kuptoje semundjen, nevojen per kontroll e tajtim te vazhdueshem dhe ka mundesi reale per te qene nen kontrollin mjekesor, jane faktore ne favor te trajtimit kirurgjikal ose endovaskular.
 - Mosha e avancuar, semundjet e renda shoqueruese, lezionet komplekse e te shtrira, pamundesi e pacientit per te qene nen kontroll te vazhdueshem mjekesor nuk favorizojne trajtimet kirurgjikale e endovaskulare ne ishemite e kompensuara.

Teknikat endovaskulare ne perdonim ne AOP jane Angioplastika perkutane me balon (PTA), Trombektomia e aterektomia perkutane dhe vendosja e stenteve endovaskulare me rruge perkutane. Keto teknika realizohen ne te gjitha nivelet e lezioneve, qofshin aorto-iliake, femoro-popliteale apo krurale.

Teknikat kirurgjikale ne lezionet aorto-iliake jane: Endarterektomia aorto-iliake, bypass aorto-bi iliak, bypass aorto-bi femoral, bypass aorto-iliak, bypass ileo-femoral, Endarterektomia iliake. Keto jane teknika qe realizojne riparimin direkt ne vendin e lezionit. Ne rastin e pacienteve me risk te larte operator realizohen teknika ekstra anatomike si bypass aksilo-femoral (uni ose bi femoral) ose femoro-femoral.

Teknikat kirurgjikale qe perdoren zakonisht ne lezionet femoro-popliteale jane: bypass femoro-popliteal 1 (mbi gju), bypass femoro-popliteal 3 (nen gju), bypass

femoro-krural (ose femoro-tibial). Me rralle perdoren endarterektomia, trombektomia dhe plastikat e ndryshme kirurgjikale.

E. Simpatektomia lumbare

Eshte nje teknike kirurgjikale qe ka indikacione te limituara ne AOP. Mund te perdoret ne pacientet qe paraqesin ishemi te stadir III sipas Fontaine dhe plage te vogla nekrotike ne kembet, me okluzione te arterieve qe nuk kane mundesi rivaskularizimi dhe qe jane ne moshe te re e me risk kirurgjikal te vogel.

F. Amputacionet

Amputacionet e vogla te nje ose disa gishtave ose transmetatarsal (tip Lis Franc) jane te pershatshme ne paciente me AOP qe paraqesin nekroza te kufizuara por tek te cilet eshte arritur rivaskularizim i mjaftueshem.

Amputimet e medha, d.m.th. nen gju ose mbi gju jane te indikuara ne:

- Paciente me nekroze te gjere te kembes ose gangrene te saj.
- Paciente me nekroze e plage ishemike por qe nuk kane mundesi rivaskularizimi per shkak te mungeses se shtratit periferik.
- Paciente me ishemi kritike por qe paraqesin risk te larte per morbiditet e mortalitet perioperator per shkak te semundjeve te renda shoqueruese, ose ne paciente me gjendje funksionale te limituar (p.sh. te paralizuar, alczhaimer, etj), ose me jetegjatesi te kufizuar per shkak te semundjeve malinje apo moshes se avancuar.

BIBLIOGRAFIA

Inter-society consensus for the management of peripheral arterial disease (TASC II)